

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra-kryetar, dhe gjyqtarët profesionistë Shadije Gërguri dhe Shashivar Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. B., për shkak të veprave penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-së, dhe Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 KPK-së, dhe kundër të akuzuarëve L. S. dhe K. P., për veprat penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 291 par. 1 lidhur me nenin 23 KPK-së, dhe Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.311-3/2007, të dt.09.08.2007, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor të dt.22.03.2017, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, të akuzuarit L. S. e K. P., dhe mbrojtësit e tyre, avoketët S. M. dhe M. N., sipas autorizimit, me dt.23.03.2017, mori dhe të njëjtën ditë, shpalli publikisht këtë :

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari K. P.**, me nofken “...” i biri i S. dhe S., e gjinisë S., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në P., ku edhe tani jeton, në Lagjen D., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

**1.**me dt.30.04.2007, rreth orës 00:45 min., në Hajvali, afër pompës së benzinës ‘...’, pas një mosmarrëveshje paraprake rreth një borxhi, të cilin ia ka patur i akuzuari H. B., një kushëri të të akuzuarit K., dhe të akuzuarit L., derisa të njëjtit ishin duke e pritur të akuzuarin tani të ndjerin H., në vendin e caktuar, posa të pandehurit e vërejnë njëri-tjetrin, me qëllim frikësimi, në të njëjtën kohë kanë shtënë, dhe atë i akuzuari H. me revolen e tipit të panjohur, në drejtim të pompës së benzinës, ku edhe ishin i akuzuari K. dhe i akuzuari L. duke e pritur, ndërsa i akuzuari K. P., me revolen e prodhimit CZECHOSLOVAKIA, me mbishkrim VZOR-70, Cal. 7.65mm, me nr.serik D-37702, ka shtënë tri herë në ajër.

-me këtë i akuzuari K. P. ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së, dhe

**2.**në kohë, vend dhe mënyrë si në dispozitivin nën 1 të aktakuzës, i akuzuari K. P. në objektin e pompës së benzinës, ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm duke shtënë me revole dhe ka shkaktuar dëm dhe shqetësim, pasi që brenda në pompë, ka qenë i dëmtuari-pronari V. G., si dhe duke i shkaktuar dëm material në frigorifer si dhe në veturën e tipit Audi, pronarit të pompës së benzinës V. G..

-me këtë i akuzuari ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 të KPPK-së

Prandaj gjykata konform dispozitive 2, 4, 34, 43 lidhur me 38, 64, dhe 328 par.1 dhe 5 të KPK-së, si dhe nenit 359, 365, 368, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, e:

### GJYKON

Për pikën I të dispozitivit të aktakuzës, me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 1(një) vit, dhe

Për pikën II të dispozitivit të aktakuzës, me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Konform nenit 80 par.1 të KPK-së, i

### SHQIPTON

**DËNIM UNIK ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, e në rast të revokimit të këtij dënimi, në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim, prej dt.30.04.2007, deri me dt.25.06.2007.

Konfiskohet arma-revolja e sekuestruar, e prodhimit CZECHOSLOVAKIA, me mbishkrim VZOR-70, Cal. 7.65mm, me nr.serik D-37702, si mjet me të cilin është kryer vepra penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 100 (njëqind) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari V. G., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër të akuzuarve H. B. dhe L. S. :

### REFUZOHET AKUZA

Për të akuzuarin tani të ndjerin H. B., për veprat penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 291 par. 1 të KPK-së, dhe Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për shkak se ka pushuar procedura kundër të njëjtit për shkak të vdekjes, konform nenit 363 par. 1 nënpar. 1.2 të KPPRK-së, dhe

Për të akuzuarin L. S., për veprat penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 291 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga akuzat, konform nenit 363 par. 1 nënpar. 1.1 të KPPRK-së,

Shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarit L. S. dhe H. B., bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut tani Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.311-3/2007, të dt.09.08.2007, kundër të akuzuarve H. B., L. S. dhe K. P., për shkak të veprave penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par. 1 të KPK-se, dhe Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 të KPPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën fillimisht ka marrë aktvendim për veçimin e procedurës penale kundër të akuzuarit H. B., për shkak se i njëjti ka vdekur, siç vërtetohet nga çertifikata e vdekjes e dt. 27.11.2014, lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Komunën e Prishtinës.

Në vazhdim të seancës së shqyrtimit gjyqësor, pas leximit të aktakuzës, prokurori i shtetit ka heq dorë nga ndjekja penale për të akuzuarin L. S., për veprat penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për shkak të mungesës së provave.

Ndërkaq, i akuzuari K. P., pas leximit të aktakuzës, e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprave penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimit të mjaftueshë me mbrojtësin e tij, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit K. P., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ashtu që të akuzuarin e shpalli fajtor për të dy këto vepra penale, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në seancën e sotme të shqyrtimit gjyqësor, u vërtetua se i akuzuari K. P., ka kryer veprat penale që i vihen në barrë, dhe atë me vetë faktin që i njëjti e ka pranuar fajësinë. Andaj i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal, të merret si rrethanë lehtësuese fakti se i njëjti e ka pranur fajësinë, si dhe ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e këtyre veprave penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av.M. N., në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes se vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, të marrë parasysh rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë në mënyrë shumë të sinqertë, pendimin për kryerjen e veprave penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se është i pa dënuar më parë, koha e kaluar nga kryerja e këtyre veprave penale, e që rezulton se kanë kaluar rreth dhjetë (10) vjetë, se te i mbrojturi i tij, është krijuar ndjenja e risocializimit, pasi që i njëjti është martuar, i ka dy fëmijë dhe punon në edukimin dhe mirëqenien e familjes, se palët janë pajtuar, dëmi nuk ka qenë i madh. Prandaj, bazuar në këto rrethana lehtësuese, ka kërkuar nga gjykata që të aplikoj dispozitat për zbutjen e dënimit, duke i shqiptuar një dënim sa më të favorshëm për të mbrojturin e tij.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit së sanksionit penal për të akuzuarën, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 64 të KPK-së, dhe si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin vlerësoi faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë, duke shprehur njëherit pendimin për veprat penale të kryera dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, se siç rezulton nga të dhënat e kësaj gjykate i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar dhe po ashtu nuk ka kryer vepër tjetër penale, se është familjar, tani më i martuar dhe baba i dy fëmijëve, mbajtësi i vetëm i familjes, koha e gjatë që nga kryerja e veprave penale. Ndërsa rrethana rënduese, gjykata nuk ka gjetur, prandaj gjykata ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit, konform nenit 34 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor wshtë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e revoles, si mjet me të cilin është kryer vepra penale, është marrë, konform nenit 328 par.5 të KPK-së, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që i dëmtuari, nuk ka qenë prezent në seancën e shqyrtimit fillestar, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe se pala e dëmtuar, deri më tani nuk është deklaruar ende lidhur me këtë çështje, nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesshëm lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr.439/2007, dt.23.03.2017**

**Procesmbajtësja**  
Mybera Latifi

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.